



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No. 04-400/01-0042940/25
Data
Data 30-09-2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për draft-buxhetin 2026-2028 i organizuar nga Kuvendi Komunal

Data: 05.09.2025

Ora: 14:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Kati IV

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu.

Adelina Spahiu: Përshëndetje për të gjithë, të nderuar anëtarë të kuvendit, qytetarë të dashur, sot jemi mbledhur për të shqyrtuar dhe diskutuar draft-buxhetin komunal. Përmes këtij dokumenti caktojmë rrugën dhe prioritetet për komunën tonë. Gjatë kësaj kohe kemi mbajtur edhe dëgjimet tjera buxhetore me shtresa të ndryshme. Fjalën ia kaloj drejtorit për buxhet dhe financa z. Ismet Aliu.

Ismet Aliu: Faleminderit kryesuese dhe të gjithë të pranishëm. Ekzekutivi i udhëhequr nga Kryetari i Komunës e ka hartuar Draft-Buxhetin për vitin 2026 dhe parashikimet për vitin 2027 dhe 2028. I ka kaluar thujtë të gjitha fazat e nevojshme për të ardhur deri te ky draft në afatin kohor kur është e paraparë me ligj dhe ndryshimet mund të propozohen deri në momentin kur del për miratim në Kuvendin e Komunës dhe pastaj të vazhdojë për Ministrinë e Financave.

Fazat që kemi kaluar deri këtu ju e dini që është një procedurë e gjatë 5 muajore me një bashkëpunim me drejtorët e drejtorive dhe të gjitha shtresat, bizneseseve, OJQ-ve dhe të gjithë ata që kanë dashur me kontribut në këtë draft-buxhet me vërejtjet dhe kërkesat e tyre, jemi munduar t'i përfshijmë. Hapi i parë ka qenë hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 i determinuar nëpër grantet specifike nga burimet e financimit që i morëm nga Ministria e Financave dhe pjesa e të hyrave vetanake e cila inkasohet nga qytetarët tanë dhe bizneset tona, e cila është diku rreth 9%.

Meqenëse kriteri numër një (1) i përfutimit të buxhetit komunal në bazë të ligjit, sigurisht e kemi sqaruar gjatë 4 viteve, është popullsia – 89% ndikon në përfutimin e buxhetit në komunë. Komuna jonë ka pasur rënie të popullsisë në regjistrimin e fundit 2024, rreth 20%. Ligji për menaxhimin e financave nuk lejon që të kemi një buxhet më të ulët dhe buxheti për vitin 2026 do të jetë pothuajse i barabartë me vitin 2025, domethënë nuk kemi rritje. Sikur të shikohej Ligji i Financave të Pushtetit Lokal ne do të kishim rënie, por ligji më i fuqishëm është Ligji për Menaxhimin e Financave që nuk ka lejuar një buxhet më të ulët.

Duke i analizuar ato grante që i kemi shpjeguar vazhdimisht si granti për financim të përgjithshëm, arsim, shëndetësi, shërbime rezidenciale të gjitha i kemi akomoduar në një strukturë buxhetit e cila ka qenë e aprovuar në kornizë, por me qarkoren e dytë kemi bërë disa ndryshime, për arsye se te fondi i pagave ka pasur një rritje prej 55€ dhe nuk ka qenë e planifikuar në kornizë, dhe kjo do të ndikojë në projektet kapitale.

Ju para e keni një fletushkë orientuese që e ka hartuar Instituti GAP me të dhënat tona që i kemi përpunuar në Kornizën Afatmesme, por ndryshimet në draft-buxhet – fondi i projekteve kapitale është zvogëluar, që ka qenë i paraparë 4,186,698 dhe është zvogëluar në 3,109,000. Jemi munduar t'i akomodojmë projektet që kanë me qenë në fazën e financimit, qoftë ato projekte që kanë me qenë vazhdim i projekteve aktuale por edhe projekte të reja të cilat duhet të përshtaten me ndarjet buxhetore me vitin 2026.

Adelina Spahiu: Faleminderit Drejtor. Vazhdo Alketa Mecini.

Alketa Mecini: Përsëritet për të gjithë. Unë kam një propozim për vitin 2026 që të hyjë një poligon sportiv i përmasave të vogla në Klinë të Epërme në lagjen Mecini, pasi që ka shumë të rinj dhe nuk kanë hapësira për aktivitete sportive. Është një shumë simbolike dhe besoj është e përballueshme për Komunën.

Besart Rrecaj: Faleminderit Kryesuese, përsëritet drejtor dhe gjithë të pranishëm. E lexova listën e projekteve të reja dhe të vjetra dhe nuk po e shoh trotuarin në fshatin Llaushë prej xhamisë deri te "Prroni i keq" ashtu si i thojmë ne, dhe në pjesën tjetër deri te lagjia Bimbashi janë diku rreth 7 apo 8 km. Ndërimi do të jetë, por kjo pjesë e trotuarit duhet të jetë e përfshirë në buxhet, apo ndoshta është planifikuar me ndonjë nënkod.

Liridona Koci: Faleminderit Kryesuese, përsëritet drejtor dhe gjithë të pranishëm. E lexova fletoren orientuese, një pyetje që dua ta bëj është ndërtimi dhe riparimi i rrugëve në bashkësinë lokale të Polacit, ku kërkoj që kjo kërkesë të merret parasysh dhe të realizohet. Ju faleminderit.

Besart Rrecaj: Sa i përket projektit të ndërtimit të bibliotekës dhe muzeut, po shoh që është një shumë prej 150,000 ku nuk është një shumë që mund të finalizohet, se me këto mjete nuk mund të kryhet as ndërtimi i vrazhdë. A kish me qenë më mirë që të pritet edhe një vit dhe të përfundohet komplet?

Kushtrim Dragaj: Faleminderit Kryesuese, përsëritet drejtor dhe gjithë të pranishëm. Deshta të informohem rreth ndërtimit publik në qytet dhe bashkësi lokale. A do të përfshihet bashkësia lokale e Runikut vitin 2026 apo do të mbesë edhe këtë vit? Dhe kanalizimi i bashkësisë lokale të Runikut është shuma 200,000 – a ka me përfshi fshatin Leginë viti 2026?

Ismet Aliu: Drejtori i Urbanizimit dhe Drejtori i Shërbimeve Publike ndoshta kish qenë më mirë të jenë dhe t'ju japin përgjigje konkrete për projektet. Megjithatë, planifikimi i buxhetit ashtu siç e keni në fletushkë është për disa që janë vazhdim. Ne kemi mbajtur dëgjimet buxhetore nëpër bashkësi lokale për kornizë dhe ka pasur një kërkesë për poligonin në Klinë të Epërme dhe trotuare. Ndërtimi i muzeut është një projekt me bashkëfinancim, po ashtu edhe ndërtimi publik është i paraparë. Në fletushkë janë vetëm planifikimet për një vit, ndërsa më vonë keni me pa se

në buxhet janë të parapara shuma për tre vitet. Çdo projekt i cili hyn në buxhet duhet t'i ketë edhe kost-benefitet e veta, me çka kuptojmë se kur investojmë në një pjesë 200,000 apo 300,000 € duhet të shikojmë se çka mbulojmë në atë pjesë të territorit. Kërkesa për poligon do të shqyrtohet nga Drejtori i Urbanizimit dhe do të shikojmë nevojën e qytetarëve për atë poligon dhe në bazë të arsyeshmërisë do të bëhet planifikimi. Riparimi i rrugëve në i kemi disa kode edhe pse nuk është i cekur një fshat, ne kemi të drejtë të bëjmë riparimin e rrugëve aty ku ka nevojë.

Kushtrim Dragaj: Tek dëgjimet buxhetore në bashkësi lokale në vitin 2023 kemi qenë së bashku në dëgjimin buxhetor në fshatin Runik, kur kemi premtuar rrugën në Leginë që e lidh rrugën Dragaj me shkollën e vjetër dhe një rrugë e një familje që ka dëshmor dhe veteran. A do të bëhet asfaltimi i këtyre rrugëve në vitin 2026 apo do të shtyhet përsëri? Komuna ka bërë një memorandum me Ministrinë e Kulturës për rregullimin e stadiumit, vendosjen e tepihut në Runik, dhe mora një informacion se klubi veçse e ka humbur klubi i Runikut ka shkuar tek një tjetër klub, por është mirë të shikohet mundësia të rregullohet terreni dhe të mos humbim donacione.

Alketa Mecini: Në Klinë të Epërme ka shumë fëmijë dhe tash ata ose janë duke luajtur në rrugë apo në vende jo të përshtatshme. Poligoni është një shumë simbolike për Komunën, pasi që në lagjen Mecini këto 4 vite nuk është që është investuar diçka. Poligoni sportiv është një kërkesë që banorët çdo herë ma thonë dhe besoj që është e duhur për ta.

Ismet Aliu: Unë vetëm e mora si shembull që çdo projekt duhet të ketë arsyeshmërinë e investimit. Ky buxhet është krijuar me kërkesat e drejtorëve edhe në projekte kapitale dhe kategori të tjera. Një buxhet që duhet të jetë i pranueshëm në bazë të qarkoreve. Ju propozoj që këto kërkesa t'i ngritni edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal.


Antigona Maliqi: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje drejtor dhe gjithë të pranishëm. Deshta të jap një sqarim rreth projektit që e përmendi Besart Rrecaj. Ndërtimi i Muzeut dhe Bibliotekës planifikimi për atë projekt nuk është vetëm shuma në vitin 2026, por edhe në vitet 2027-2028 janë planifikuar shuma.


Kushtrim Dragaj: Ne përfaqësojmë të gjithë qytetarët e Komunës së Skenderajt, por me fokus të veçantë bashkësinë lokale të Runikut. Prej vitit 2004 e kemi një ujësjellës që e kemi në shfrytëzim, por moskujdesja e Komunës ndaj ujësjellësit dhe kycjet ilegale ka bërë që të kemi mungesë të ujit. Kisha pasur kërkesë, pasi që kanë ardhur pompat deri te bazenat në fshatin Vitak, të shikojmë mundësinë që t'i bartim edhe tek ujësjellësi në Runik, që të paktën të kemi ujë 2-3 herë në javë, që qytetarët të mos kenë nevojë të mbajnë ujë me cisterna.

Adelina Spahiu: A ka ndokush ndonjë propozim? Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka me shtuar, me kaq e mbylli këtë dëgjim buxhetor.









Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal

Vendi dhe data: E premte, 05 Shtator 2025, ora 14:00

Salla e Kuvendit Komunal. Skenderai


[illegible]



Karlshagen-Karlsruhe

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Nr. _____
No. 02-400/01-0035007/25
Data: _____
Data: 15. 08. 2025

Kalendari i dëgjimeve buxhefore publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2026

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt, dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2026.

Këto dëgjime buxhetore do të mbahen me datë 29 Gusht 2025 sipas kalendarit të detajuar. Në këto dëgjime buxhetore mund të marrin pjesë : qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë të tjerë pa dallim për ta dhënë kontributin e tyre në hartimin e buxhetit për vitin 2026.

Nr	Dëgjimi buxhetor me qytetarë	Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Vendi i mbajtjes	Ora
1	Dëgjimi buxhetor me grupet e grave, studentët dhe të rinjtë, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarë të tjerë	E premte, 29 Gusht 2025	Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV	10:00
2	Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e bizneseve dhe fermerët e komunës së Skenderajt	E premte, 29 Gusht 2025	Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV	11:00
3	Dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, shoqëri të civilë, klube sportive, artistët, qytetarë të tjerë)	E premte, 29 Gusht 2025	Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV	14:00

4	Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor me përfaqësues të lagjeve dhe fshatrave dhe qytetarë të tjerë	E premte, 29 Gusht 2025	Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV	15:00
5	Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor i organizuar nga Kuvendi Komunal	E premte, 5 shtator 2025	Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV	14:00

Për më shumë detaje, për Qarkoren buxhetore përmes të cilës hartohet Propozim-buxheti për Komunën e Skenderajt mund të vizitoni vegëzën e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/shpalljet/?tax=diskutimet-publike>

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në emailat: ismet.aliu@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.

Udhëheqës i Zyrës për Informim



Amir Lushtaku

